



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1769 prot.

Tiranë, më 20 . 11 . 2019

**Lënda:** Sugjerime mbi projekt-vendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr.319, datë 15.04.2015, të Këshilliun e Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformen ne Administratën Publike 2015-2020”, të ndryshuar”.

**Z. ËNGJËLL AGAÇI**  
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**KRYEMINISTRIA**

**TIRANË**

**I nderuar Z. Agaçi,**

Në vijim të shkresës Tuaj, nr.4696/4, datë 22.10.2019 me lëndë “Kërkohet mendim për një projektvendim”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u njoh me Planin e Veprimit “Për reformën në Administratën Publike 2018-2022”, sugjerojmë si më poshtë vijon:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk është pjesë “si institucion përgjegjës”, në Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike.

Në Planin e Veprimit “Për reformen në Administratën Publike 2018-2022” në Aktivitetin 5.3 “Zhvillimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike”, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në respektim të legjislacionit të aksesueshmërisë, propozojmë të shtohen dy nënaktivitete si më poshtë:


Në vijim të nën-aktivitetit 5.3.2 “Cilësia e ofrimit të shërbimeve publike pranë qendrave të integruara dhe sporteve të Shërbimeve ADISA”, propozojmë të shtohet edhe nën-aktiviteti 5.3.3 me titull: “Monitorimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për personat me aftësi të kufizuara nga ADISA”, ku institucion përgjegjës është Agjensia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

Në vijim të nën-aktivitetit 5.3.3 “Zbatimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë institucioneve të qeverisjes qendrore”, të shtohet edhe nën-aktiviteti 5.3.4 me titull “Monitorimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për personat me

*afësi të kufizuara në administratën publike”, ku institucione përgjegjëse të jenë Ministrinë e linjës.*

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**ROBERT GAJDA**



**KOMISIONERI**

